

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8391
E shtunë, 19 shtator 2026
Çmimi 0.50 €

Von der Leyen anashkalon
Serbinë dhe Bosnjën në
turneun e saj në Ballkan

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

'JO NË EMRIN TIM', 'LIRI, LIRI'. MIJËRA QYTETARË PROTESTUAN NË PRISHTINË KUNDËR VENDIMIT TË GJYKATËS SPECIALES

FAQE 4-5



Mijëra qytetarë kanë protestuar të premten në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë për të kundërshtuar vendimin dënues të Speciales ndaj katër ish-udhëheqësve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Në protestën e thirrur nga Organizata e Veteranëve

të Luftës së UÇK-së, kërkesat e protestuesve ishin: Shfuqizimi ose ndryshimi i ligjit për Dhomat e Specializuara; shkarkimi i ministres së Drejtësisë, Donika Gërvalla, mbështetje e pakufizuar dhe fonde të mjaftueshme për mbrojtjen e të

pandehurve dhe angazhimit të ekspertëve më të mirë ndërkombëtar në mbrojtje të UÇK-së. Protesta u zhvillua me moton "Në mbrojtje të UÇK-së", ndërsa një nga mesazhet e përcjella nga protestuesit ishte "Jo në emrin tim!"

AKTGJYKIMI QË MOHOI
JURISPRUDENCËN
NDËRKOMBËTARE

**VENDIMI I 16 SHTATORIT
- THIKË PAS SHPINE
PAVARËSISË SË KOSOVËS**

F. 5

Bardhyl MAHMUTI



**PDK-ja NDERON
BASHKËVEPRIMTAREN
FLORA BROVINA,
HAMZA: SIMBOL
I QËNDRESËS DHE
ATDHEDASHURISË**

F. 3



AKTUALE



**SHTËPIA E BARDHË HEDH POSHTË
RAPORTIN E OKB-SË QË PRETENDON
SE SHBA-JA KA KRYER KRIME LUFTË
NË IRAN**

F. 2

**HAMZA BISEDON ME KURTIN,
ABDIXHIKUN DHE GJININ PËR
VENDIMIN E SPECIALES**

F. 3

**OFICERI I FSK-SË DIPLOMON
NË SHBA**

F. 3

EKONOMI



**GUVERNATORI ISMAILI MERR PJESË
NË SAMITIN FINANCIAR TË
BUDAPESTIT 2026, TË ORGANIZUAR
NGA BANKA QENDRORE E
HUNGARISË**

F. 3

**KOMPANITË GJERMANE SHPREHIN
INTERESIM PËR INVESTIME NË
KOSOVË**

F. 8

SPORT



**FODA PUBLIKON LISTËN ZYRTARE
TË KOSOVËS, SHUMË RISI DHE
MUNGESA TË MËDHA**

F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +389 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Peshko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

VON DER LEYEN ANASHKALON SERBINË DHE BOSNJËN NË TURNEUN E SAJ NË BALLKAN

BRUKSEL, 18 SHTATOR - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, do t'i anashkalojë Serbinë dhe Bosnje e Hercegovinën gjatë turneut të saj në Ballkan, njoftoi të premten Komisioni Evropian (KE). "Gjatë turneut, presidentja von der Leyen do t'i vizitojë Tiranën, Prishtinën, Podgoricën dhe Shkupin. Atje do të takohet me presidentët dhe kryeministrat, si dhe do të vizitojë projekte të financuara nga Bashkimi Evropian", tha zëdhënësja e KE-së, Arianna Podesta. Vizita në katër vendet e rajonit është paraparë të zhvillohet nga

30 shtatori deri më 2 tetor. Radio Evropa e Lirë kishte raportuar më herët për mundësinë që von der Leyen, nëse nuk do ta vizitonte Serbinë, të mos shkonte as në Bosnje e Hercegovinë. Von der Leyen prej vitesh ka pasur një raport të ngrohtë me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, të cilit shpesh i është drejtuar me fjalët "i dashur Aleksandar". Kjo qasje është kritikuar nga ekspertë që merren me Ballkanin Perëndimor. Dy burra të mbështjellë me rroba që shfaqin figurën e kriminelit të dënuar të luftës,



Ratko Milladiq, marrin pjesë në varrimin e ish-komandantit të Ushtrisë së Republikës Sërpska, i dënuar nga Tribunali i Hagës për gjenocid në Bosnje, Beograd 7 shtator 2026. Më herët ishte thënë se von der Leyen nuk do ta vizitonte

Serbinë gjatë turneut ballkanik për shkak të tensioneve politike dhe shoqërore në vend, ndërsa varrimi i Ratko Mlladiqit, i dënuar për krime lufte dhe gjenocid, kishte nxitur reagime të ashpra në Bashkimin Evropian. Edhe disa deputetë të Parlamentit Evropian i kishin bërë thirrje von der Leyenit që të mos udhëtonte në Beograd. Në prag të zgjedhjeve parlamentare dhe të përgjithshme në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë, von der Leyen planifikon t'i vizitojë këto dy vende më vonë, tha Podesta. Ky do të jetë turneu i gjashtë i

von der Leyenit në rajon, një vizitë që tashmë është bërë traditë para publikimit të paketës vjetore të raporteve të progresit për vendet candidate për anëtarësim në BE. "Siç tha presidentja në samitin e qershorit, Bashkimi ynë nuk do të jetë i plotë pa Ballkanin Perëndimor. Gjatë bisedimeve me partnerët, ajo do të diskutojë për hapat e nevojshëm në rrugën e këtyre vendeve drejt Bashkimit Evropian, si dhe për procesin e integritetit gradual, të mbështetur nga Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor", tha zëdhënësja Podesta.

SHTËPIA E BARDHË HEDH POSHTË RAPORTIN E OKB-së QË PRETENDON SE SHBA-ja KA KRYER KRIME LUFTE NË IRAN

UASHINGTON, 18 SHTATOR - Shtëpia e Bardhë ka hedhur poshtë një raport të një misioni të pavarur faktmbledhës të Kombet e Bashkuara, i cili tha se ka dyshime të arsyeshme për të besuar se Shtetet e Bashkuara kanë kryer krime lufte gjatë dy sulmeve ajrore në Iran. Misioni i Pavarur Ndërkombëtar Faktmbledhës për Iranin tha në një raport të publikuar më 17 shtator se ka dyshime të arsyeshme për të besuar se forcat amerikane kishin kryer krim lufte gjatë sulmeve ndaj një shkollë në

Minab dhe ndaj një objekti sportiv në Lamerd më 28 shkurt. Sipas misionit, në dy sulmet u vranë të paktën 178 civilë, përfshirë gra dhe fëmijë. Sulmi në Minab goditi Shkollën Filllore Shajareh Tayyebbeh dhe vrau më shumë se 150 persona, përfshirë rreth 120 nxënës. Një sulm i ndarë ndaj një kompleksi sportiv dhe zonës së banuar përreth në Lamerd vrau 22 civilë. Në një përgjigje të ashpër me shkrim ndaj raportit, zëdhënësja e Shtëpisë së



Bardhë, Anna Kelly, i hodhi poshtë gjetjet. "E vetmja palë në këtë konflikt që ka kryer krime lufte është regjimi iranian, i cili ka vrarë mijëra njerëz të vet, ka vrarë amerikanë jashtë vendit, ka kryer akte terrorizmi në Ngushticën e Hormuzit dhe ka kryer sulme pa dallim ndaj

fqinjëve të tij në rajon", tha ajo. Kelly tha po ashtu se Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut "nuk ka bërë asgjë për të drejtat e njeriut, teksa për dekada ka thënë broçkulla joserioze". Zyrtarët amerikanë kanë thënë vazhdimisht se operacionet ushtarake kryhen në përputhje me ligjin për konflikt të armatosur dhe se po zhvillohet një hetim. SHBA-ja dhe Izraeli nisën sulmet ajrore ndaj Republikës Islamike në fund të shkurtit dhe Irani u kundërpërgjigj duke kryer sulme në mbarë rajonin e Lindjes së Mesme.

Raporti pritet t'i prezantohet zyrtarisht Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, që ka 47 anëtarë, në Gjenevë më 21 shtator. Misioni po ashtu tha se ka dyshime të arsyeshme për të besuar se autoritetet iraniane kryen krime kundër njerëzimit gjatë shtypjes së protestave mbarëkombëtare në dhjetor 2025 dhe janar 2026. Ai përmendi vrasje të paligjshme, ndalime arbitrare, torturë dhe akte të tjera çnjerëzore të kryera si pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik ndaj civilëve.

RUSËT VOTOJNË NË ZGJEDHJET E PARA PARLAMENTARE QË NGA NISJA E PUSHTIMIT TË UKRAINËS MË 2022

MOSKË, 18 SHTATOR - Rusët kanë filluar të votojnë për t'i zgjedhur deputetët e Dumës së Shtetit, në një kohë kur lufta gati pesëvjeçare në Ukrainë dhe ngadalësimi i ekonomisë po rëndojnë mbi vendin. Këto janë zgjedhjet e para parlamentare qëkurse Moskë e nisi pushtimin e vendit fqinj më 2022. Votuesit në rajonin e Paqësorit, Kamçatka, që ndodhet nëntë zona kohore përpara Moskës, nisën procesin e votimit më 18 shtator, i cili do të zgjasë deri më 20 shtator. Rezultatet zyrtare për përbërjen e re të dhomës së ulët të Parlamentit, me 450 vende, priten kah 22 shtatori. Rusia e Bashkuar, partia e lidhur me Kremlinin që mbizotëron Dumën, si dhe parlamentet dhe qeveritë rajonale në mbarë vendin, pritet ta ruajë ose të rrisë shumicën e saj. Qëkurse presidenti Vladimir Putin erdhi në pushtet më shumë se çerek shekulli më parë, Kremlinin ka shtypur gjithnjë e më shumë zërat kundërshtarë, ka marginalizuar kundërshtarët

politikë dhe ka manipuluar zgjedhjet, duke lënë pak hapësirë për befasi. Ndërkohë, e vetmja parti politike e njohur që kundërshtonte luftën nuk u lejua të merrte pjesë në zgjedhje disa javë para votimit. Mes frikës së Kremlinin nga apatia dhe zhgënjimi, Putin, i cili shpesh e akuzon Perëndimin se synon ta dobësojë ose shkatërrojë Rusinë, u bëri thirrje rusëve të votojnë, duke i cilësuar zgjedhjet si tregues të mbështetjes për luftën. Sipas vlerësimeve perëndimore, më shumë se 1.5 milionë ushtarë rusë janë vrarë ose plagosur në konflikt. "Zgjedhja dhe vullneti juaj do të tregojnë edhe një herë se miliona njerëz qëndrojnë pas trupave tona, se jemi një popull i bashkuar nga vlerat e përbashkëta, kujtesa historike dhe dashuria për atdheun, dhe askush nuk do të arrijë të na përcajë apo frikësojë, ose ta minojë sovranitetin apo sistemin tonë politik-shoqëror", tha Putin në një fjalim të publikuar më 16 shtator. Autoritetet ruse pushtuese kanë ngritur qendra votimi në pjesët e



kontrolluara nga Rusia të pesë rajoneve ukrainase, të cilat Moskë i ka shpallur territor rus. Kiev i ka dënuar këtë përpjekje. Derisa nuk priten ndryshime dramatike në përbërjen e Dumës, Kremlinin - dhe organi i fuqishëm i politikëbërjes së brendshme, i njohur si Administrata Presidenciale - pritet t'i vëzhgojë rezultatet për të kuptuar shenjat e gjendjes shpirtërore qytetarëve të vendit. Megjithatë është e vështirë të zhvillosh sondazhe të opinionit në Rusi, për shkak të politikave shtypëse që kanë kriminalizuar mospajtimin ose kundërshtimin e luftës, disa sondazhe kanë treguar rënie të popullaritetit të Putinit, si dhe të Rusisë së Bashkuar. Vetë Putin fitoi zgjedhjet në vitin

2024, në një votim që në masë të madhe u konsiderua si i paracaktuar dhe u shoqërua me prova për mashtrim. Një numër në rritje i rusëve kanë humbur durimin me luftën, e cila është më e madhja në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Humbjet totale të Rusisë tejkalojnë ato që vendi pësoi në të gjitha luftërat që Moskë ka zhvilluar që nga viti 1945. Humbjet e Ukrainës janë më të ulëta në total, por gjithsesi jashtëzakonisht të larta. Komandantët ushtarakë kanë paraqitur vazhdimisht një tablo optimiste për mënyrën se si po performojnë trupat ruse në fushëbetejë, ndërsa Kremlinin ka sugjeruar vazhdimisht se fitorja është e sigurt. Rusët janë gjithashtu të shqetësuar për mundësinë e një mobilizimi tjetër, të ngjashëm me atë që Putin urdhëroi në shtator të vitit 2022. Kjo përpjekje, që përfshiu mobilizimin e 300.000 burrave, kryesisht rezervistë, tronditi shoqërinë ruse dhe çoi në largimin e qindra mijëra njerëzve nga vendi.

Ndërkohë, ekonomia ka pësuar një ngadalësim të ndjeshëm pas muajsh rritjeje të vrullshme, të nxitur nga shpenzimet qeveritare për gjëra të lidhura me luftën, si pagat e ushtarëve, kompensimet për vdekjet dhe investimet në armatime dhe armë. Banka Qendrore ka hasur vështirësi në frenimin e inflacionit, i cili është shumë mbi pritshmëritë. Një fushatë e gjerë ukrainase me dronë dhe raketa ka shkaktuar mungesa karburanti në gjithë vendin dhe ka penguar funksionimin e shitësve më të mëdhenj online në vend. Opozita ruse, e përçarë dhe e goditur rëndë, u ka bërë thirrje njerëzve të votojnë për cilindo kandidat që shpreh qëndrim kundër luftës. Megjithatë, partia liberale më e njohur e vendit, Jabloko, nuk u lejua të paraqiste kandidatë në zgjedhjet për Dumën për shkak të një çështjeje teknike. Jabloko kishte përfshirë një platformë kundër luftës në fushatën e saj dhe disa sondazhe kishin treguar një rritje të ndjeshme të mbështetjes për të.

Hamza bisedon me Kurtin, Abdixhikun dhe Gjini për vendimin e Speciales

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Kreu i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, tha se me kërkesë të tij, është takuar me udhëheqësit partiakë dhe shtetërorë, për të biseduar për aktgjykimin dënues të Dhomave të Specializuara të Kosovës ndaj katërshes së UÇK-së.

Më 16 shtator, Hashim Thaçi, ish-president i Kosovës, dhe Jakup Krasniqi, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës, u dënuan me nga 25 vjet burgim. Kadri Veseli, po ashtu ish-kryetar i Kuvendit, u dënua me 18 vjet burgim, ndërsa Rexhep Selimi, ish-deputet, me 13 vjet.

Hamza zhvilloi takime të ndara me udhëheqësin e Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, me kreun e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku dhe atë të Aleancës, Ardian Gjini. “Ne biseduam për seriozitetin e situatës së krijuar, sfidat me të cilat po përballemi, si dhe për mundësitë e bashkëpunimit në këtë periudhë të rëndësishme për popullin dhe shtetin tonë”, shkroi Hamza në rrjetet sociale.

Paraprakisht, Qeveria e Kosovës njoftoi se Kurti me Hamzën bisedoi për mënyrat që duhen ndjekur “për të korrigjuar” aktgjykimin dënues ndaj katër ish-eprorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të shpallur nga Dhomat e Specializuara të Kosovës. “Duke e vlerësuar aktgjykimin të padrejtë, të rëndë dhe me pasoja të gjera, kryeministri Kurti theksoi se ai duhet ndryshuar pozitivisht në shkallën e apelit. Kurti e Hamza ndanë mendimet dhe përshtypjet e tyre si dhe diskutuan se cilat do të ishin rrugët e mënyrat që duhet ndjekur përpara për të korrigjuar vendimin e djeshëm”, u tha në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.



GUVERNATORI ISMAILI MERR PJESË NË SAMITIN FINANCIAR TË BUDAPESTIT 2026, TË ORGANIZUAR NGA BANKA QENDRORE E HUNGARISË

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Me ftesë të guvernatorit të Magyar Nemzeti Bank (Bankës Qendrore të Hungarisë), Mihály Varga, guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, mori pjesë në Samitin Financiar të Budapestit 2026, të mbajtur nën temën “Bankingu Qendror në një Botë të Fragmentuar”.

Para hapjes së Samitit Financiar, guvernatori Varga zhvilloi një takim me guvernatorin Ismaili dhe Fatih Karahan, guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë, me pjesëmarrjen e Daniel Palotai, Zëvendësguvernator i Magyar Nemzeti Bank dhe Yigit Yaşar, drejtor ekzekutiv në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Gjatë Samitit dhe aktiviteteve të tjera përcjellëse, guvernatori Ismaili shkëmbeu pikëpamje me guvernatorë të bankave qendrore, përfaqësues të institucioneve financiare ndërkombëtare dhe pjesëmarrës të tjerë lidhur me zhvillimet që ndikojnë në sistemin financiar ndërkombëtar, stabilitetin dhe qëndrueshmërinë financiare, mbikëqyrjen dhe rregullimin bankar, si dhe sfidat në zhvillim me të cilat përballen bankat qendrore.

Në këto shkëmbime, guvernatori Ismaili theksoi stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e vazhdueshme të sektorit financiar të Kosovës, si dhe progresin e arritur në forcimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse dhe avancimin e përafritimit të saj me standardet e Bashkimit Evropian.

Samiti Financiar i Budapestit mbledhi guvernatorë të bankave qendrore, përfaqësues të lartë të institucioneve financiare ndërkombëtare, politikëbërës dhe ekspertë për të diskutuar çështjet kryesore që po formësojnë të ardhmen e bankut qendror.

Në sfondin në rritje të fragmentimit gjeopolitik dhe ekonomik, guvernatori Ismaili theksoi rëndësinë e multilateralizmit, dialogut institucional dhe bashkëpunimit efektiv ndërkombëtar.

BQK-ja mbetet e përkushtuar ndaj angazhimit aktiv ndërkombëtar dhe forcimit të bashkëpunimit me bankat qendrore homologe dhe institucionet ndërkombëtare, duke avancuar stabilitetin financiar, modernizimin rregullator dhe integrimin e Kosovës në arkitekturën financiare evropiane.



PDK-ja NDERON BASHKËVEPRIMTAREN FLORA BROVINA, HAMZA: SIMBOL I QËNDRESËS DHE ATDHEDASHURISË



PRISHTINË, 18 SHTATOR - Partia Demokratike e Kosovës ka nderuar të premten veprimtaren, mjeken dhe intelektualen, Flora Brovina. Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza,

i shoqëruar nga deputetë, anëtarë të Kryesisë së PDK-së dhe bashkëpunëtorë, mori pjesë në Akademinë Përkujtimore dhe bëri homazhe në Kuvendin e Kosovës, në nderim të figurës së Flora Brovinës.

Ata vlerësuan kontributin e saj si mjekë, intelektuale dhe veprimtare që gjithë jetën ia kushtoi Kosovës dhe qytetarëve të saj. “Për mua, për PDK-në dhe për të gjithë ata që patën fatin ta njohin, Flora Brovina do të mbetet përgjithmonë një simbol i qëndresës, i humanizmit dhe i atdhedashurisë”, ka theksuar kryetari Hamza.

Emri dhe vepra e Flora Brovinës mbeten dëshmi e një jete të jetuar me dinjitet dhe në shërbim të vendit, u tha në mbledhjen komemorative në nderim të mjekes, poetes, veprimtares dhe ish-deputetes së Kuvendit të Kosovës, Flora Brovina, e cila ndërroi jetë më 15 shtator, në moshën 76-vjeçare.

Në këtë tubim, bashkëveprimtarë, mjekë, ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjarë të figurave të luftës folën për jetën dhe veprimtarinë e Brovinës, duke veçuar angazhimin e saj në mjekësi, humanizëm, letërsi dhe në periudhën e luftës në Kosovë.



Oficeri i FSK-së diplomon në ShBA

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Toger Etnik Kastrati ka përfunduar me sukses trajnimin “Infantry Basic Officer Leader Course” (IBOLC) në Fort Benning, Georgia, një nga kurset kryesore për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të oficerëve të rinj të këmbësorisë.

Trajnimi përmban një program të fokusuar në zhvillimin e aftësive të udhëheqjes, planifikimit dhe ekzekutimit të operacioneve taktike, përdorimit të armëve, navigimit tokësor, stërvitjes së njërive dhe drejtimit të trupave në kushte të ndryshme operacionale. Bazuar në rezultatet e arritura, përkushtimin dhe performancën e treguar gjatë gjithë trajnimit, Toger Kastrati ka marrë çmimin “International Distinguished Honor Graduate”, një vlerësim për performancën e tij të treguar gjatë trajnimit.

Ky sukses përfaqëson një arritje të rëndësishme në zhvillimin e tij profesional si Oficer i Këmbësorisë dhe një tjetër dëshmi të përkushtimit për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe përfaqësimin e denjë të Kosovës në arenën ndërkombëtare.





'JO NË EMRIN TIM', 'LIRI, LIRI'. MIJËRA QYTETARË PROTESTUAN NË PRISHTINË KUNDËR VENDIMIT TË GJYKATËS SPECIALES

Mijëra qytetarë kanë protestuar të premten në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë për të kundërshtuar vendimin dënues të Speciales ndaj katër ish-udhëheqësve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Në protestën e thirrur nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, kërkesat e protestuesve ishin: Shfuqizimi ose ndryshimi i ligjit për Dhomat e Specializuara; shkarkimi i ministres së Drejtësisë, Donika Gërvalla, mbështetje e pakufizuar dhe fonde të mjaftueshme për mbrojtjen e të pandehurve dhe angazhimin e ekspertëve më të mirë ndërkombëtar në mbrojtje të UÇK-së. Protesta u zhvillua me moton "Në mbrojtje të UÇK-së", ndërsa një nga mesazhet e përcjella nga protestuesit ishte "Jo në emrin tim!"

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Mijëra qytetarë u mblodhën të premten në kryeqytetin Kosovës duke e kundërshtuar dënimin me burgim për katër ish-krerë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë ditë më parë. Hashim Thaçi, Kadi Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi,

të cilët udhëhoqën UÇK-në gjatë luftës së saj kundër forcave serbe më 1998-99, u shpallën fajtorë më 16 shtator nga ajo që njihet edhe si Gjykata Speciale e Kosovës, për katër akuza për krime lufte dhe u dënuan me 81 vite burgim. Ata i kanë mohuar akuzat dhe kanë thënë se do të ankohen ndaj aktgjykimit të shkallës së parë në Apelin e Speciales. Dënimi i tyre me burgim është kritikuar ashpër në Kosovë, ku

ata shihen si heronj kombëtarë. Gjatë fjalimit në protestë, kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, tha se sot "të gjithë jemi UÇK". "Sot jemi tubuar këtu për ta ngritur zërin kundër një padrejtësie të madhe. Ne sot kërkojmë që këtë vendim Gjykata Speciale ta shfuqizojë dhe ta marrë parasysh këtë popull që është ngritur", tha Gucati. Në fund të protestës,

organizatorët shpалosën katër kërkesa drejtuar Qeverisë dhe Presidencës së Kosovës: Shfuqizimin ose ndryshimin e ligjit për Dhomat e Specializuara; shkarkimin e ministres së Drejtësisë, Donika Gërvalla, mbështetje e pakufizuar dhe fonde të mjaftueshme për mbrojtjen e të pandehurve dhe angazhimin e ekspertëve më të mirë ndërkombëtar në mbrojtje të UÇK-së.

Gërvalla është kritikuar për mungesë reagimi ndaj Gjykatës Speciale për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së. Gucati tha se "ne e dimë që Gërvalla ka dorëzuar dokumentacione në Hagë", duke shtuar se kryeministri Albin Kurti "duhet nga sot të largojë nga Qeveria njerëz si ajo".

Ndërkaq Dardan Islami, në protestën gjithëpopullore në kundërshtim të vendimit dënues ndaj ish-krerëve të

UÇK-së, tha se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte ajo që qytetarët i bashkoi para 26 vjetësh.

Sipas tij, ky bashkim i tregoi botës se gjithçka është e mundur. "I treguam botës që gjithçka është e mundur, se lufta për liri, dëshira për liri është më e madhe se çdo ushtri tjetër, se çdo armik tjetër. E sot, është po e njëjta UÇK që u përballë me forcat serbe, u ballafaqua me UNMIK-un e EULEX-in, që 26 vjet, dhe do të dalë faqebardhë edhe këtë herë, do të triumfojë, dhe do t'i tregojë botës se shqiptarët nuk e kanë dëzë luftën, nuk ia kanë krisë këngës për t'i sunduar të tjerët", tha ai.

Protestuesve u është drejtuar edhe djali i Jakup Krasniqit, Altini.

Ai u ka bërë thirrje të gjithëve që t'i lënë anash dallimet politike dhe të bëhen bashkë. "Ju falënderoj nga zemra për mbështetjen e vazhdueshme.

Jam para jush jo vetëm si biri i një njeriu që po përballet me këtë padrejtësi, por si biri i këtij populli. Lufta jonë ka qenë për liri, për dinjitet, luftë e një populli që për dekada ka qenë i përbuzur. Ajo që ndodhi në Hagë nuk është çështje ndaj katër individëve. Ky aktgjykim prek një histori të madhe, prek sakrificën e çdo dëshmori, çdo veterani, çdo të burgosuri politik e çdo të zhdukuri, e çdo fëmijë që nuk arriti ta shijojë Kosovën e lirë. Sot nuk do të dorëzohemi. Nëse dorëzohemi sot, do të na gjykojë edhe e ardhmja. Do të na pyesin fëmijët tanë se çfarë bëtë kur historia iu vuri në bankën e të akuzuarve, çfarë bëtë kur çlirimtarët u vunë në pikëpyetje. Përgjigjja jonë do të jetë e qartë: Nuk u dorëzuam. Do të vazhdojmë të kërkojmë drejtësi! Prandaj sot i bëj thirrje të gjithë shqiptarëve dhe të gjitha partive politike, t'i lëmë anash dallimet politike, të bashkohemi", tha Krasniqi, i cili është deputet i Kuvendit të Kosovës.

Në protestën që u mbajt në sheshet kryesore të kryeqytetit morën pjesë edhe politikanë të lartë, përfshirë kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, deputetë të kësaj partie dhe të Aleancës, përfshirë Ramush Haradinajn. Protestuesit dëgjoheshin duke brohoritur "UÇK" dhe duke mbajtur në dorë pankarta me mbishkrime kundër vendimit të gjykatës.

Policia tha se protesta mbaroi pa ndonjë incident dhe se protestuesit u shpërndanë të qetë.

Para protestës, Policia e Kosovës u bëri thirrje

pjesëmarrësve t'i ndjekin udhëzimet e zyrtarëve policorë, të mos hedhin gjësende e mjete të forta dhe të mos përdorin maska.

Djali i Kadri Veselit pas protestës: Nuk e kemi humbur besimin te drejtësia perëndimore

Klestor Veseli, djali i ish-kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli, ka folur pas përfundimit të protestës në Prishtinë.

Veseli tha se familjet dhe mbështetësit e ish-krerëve të UÇK-së nuk e kanë humbur besimin te bota perëndimore dhe drejtësia e saj. "Nuk e kemi humbur besimin te bota perëndimore, tek drejtësia e tyre. Ne vetëm po kërkojmë korrigjim të një gabimi që ka qenë i zhytur në politikë. Faleminderit edhe juve që po i kushtoni vëmendje kësaj pune", tha Klestor Veseli.

Po ashtu edhe kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, së bashku me deputetët e kësaj partie, i janë bashkuar të premtën protestës gjithëpopullore në mbështetje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të organizuara nga shoqatat e luftës, në Prishtinë.

Në një prononcim për gazetarë, ai tha se vendimi dënues i Gjykatës Speciale është i papranueshëm dhe, sipas tij, i pabazuar në fakte.

Hamza tha se kjo protestë nuk është drejtuar ndaj askujt, por është në përkrahje të plotë për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin. "Ne jemi për drejtësi dhe jemi kundër padrejtësisë. Në këtë gjykatë çfarë kemi parë?





Kemi parë padrejtësi. Ky është një vendim i papranueshëm për qytetarët e Kosovës, vendim i padrejtë, i pabazuar në fakte, është vendim politik dhe sigurisht ne jemi këtu me shpreh pakënaqësinë tonë. Kjo protestë është në përkrahje të liderëve tanë, të udhëheqësve të UÇK-së. Nuk është e drejtuar ndaj askujt, por në përkrahje të tyre të plotë. Do të bëjmë gjitha veprimet e nevojshme demokratike e ligjore, por edhe protesta”, tha Hamza.

Edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka marrë pjesë në këtë protestë. Limaj tha se një nga çështjet kryesore që duhet të diskutohet është integriteti i gjyqtarëve që marrin vendime në këto procese.

Ai tha se gjyqtari që ka udhëhequr trupin gjykues ka zbatuar urdhra politikë. “Po e shihni sa i rëndësishëm është integriteti personal i një gjyqtari. Një gjyqtar që hapur ka zbatuar urdhra politikë dhe ka kryesuar trupin gjykues”, është shpreh ai.

Limaj tha se vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet pikëpyetjeve rreth personave që gjykojnë dhe integritetit të tyre. “Një nga temat kryesore që duhet të diskutohet është pikëpyetja e atyre që gjykojnë, pra integriteti i atyre që gjykojnë, ndaj një padrejtësie që po bëhet ndaj njerëzve nga njerëz pa integritet. Dhe gjëja e parë që

duhet të kërkohet është, kush janë gjyqtarët dhe cili është integriteti i tyre...”, tha mes tjerash ai.

Gjatë protestës pranë objektit të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit, EULEX, në Prishtinë, i cili u përfshiu pjesërisht zjarri të mërkurën, kishte protestues të maskuar.

Protesta e së premtes, e thirrur nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, ishte vazhdimësi e protestave të mbajtur në vend qëkurse gjykata i shpalli ata fajtorë.

Një ditë më parë, Thaçi, ish-president i Kosovës, u bëri thirrje qytetarëve ta ruajnë qetësinë pas aktgjykimit dënues ndaj tij dhe bashkëluftëtarëve të tij.

Avokati i tij, Luka Mishetiç, përcolli mesazhin e Thaçit të enjten, ku ai falënderoi qytetarët për mbështetjen dhe e cilësoi vendimin e 16 shtatorit të padrejtë.

Avokati i Thaçit i reagon ashpër Marta Kosit: Nuk të takon ta paragjykosësh çështjen e aktgjykimit

Avokati i ish-presidentit Hashim Thaçi, Luka Mishetiç, ka reaguar pas deklarimeve të zyrtares së lartë të Bashkimit Evropian, Marta Kos, lidhur me Dhomat e Specializuara të Kosovës. Përmes një postimi në



platformën X, Mishetiç ka qenë i ashpër ndaj saj.

Kryembrojtësi i Thaçit ka shkruar se nuk i takon Kosit që ta paragjykojë çështjen e aktgjykimit, nëse Specialja ka vepruar në mënyrë të njëanshme apo jo. “Ende duhet të përcaktohet nëse Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë vepruar në mënyrë të

paanshme në rastin e z. Thaçi. Nuk i takon Marta Kos-it ta paragjykojë këtë çështje. Komiteti i të Drejtave të Njeriut të Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit ka vënë në pikëpyetje paanshmërinë e gjyqtarëve të trupit gjykues në këtë rast. Raportin e tyre mund ta lexoni këtu”, ka shkruar Mishetiç.

Ai në postimin e tij ka publikuar

edhe një raport të Komitetit të të Drejtave të Njeriut të Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit, i cili trajton çështjen e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Ndryshe, komisionerja për Zgjerim, Kos, në ditën kur u shpall aktgjykimi, shkroi se Specialja është e paanshme dhe e pavarur, ndërsa vendimi duhet të respektohet.



AKTGJYKIMI QË MOHAI JURISPRUDENCËN NDËRKOMBËTARE

VENDIMI I 16 SHTATORIT - THIKË PAS SHPINE PAVARËSISË SË KOSOVËS



Bardhyl MAHMUTI

Reagimet e shumta në të katër anët e botës ndaj vendimit të 16 shtatorit, ka nxitur sajuesit dhe instrumentet e tyre të përpigën të manipulojnë me opinionin publik, duke fshehur qëllimin e vërtetë të aktgjykimit: dënimin e luftës çlirimtare dhe pavarësinë e Kosovës.

Kështu prokurorja Kimberly West deklaroi se gjoja “ZPS-ja nuk ka ndjekur penalisht Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, as luftën e bërë për pavarësinë e Kosovës.” Bisht pas saj, publicistë, analistë dhe lloj-lloj individësh përpigën të shesin gënjeshtër e paketuar se aktgjykimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit vendosi përgjegjësi penale individuale dhe nuk e kriminalizon synimin për pavarësinë e Kosovës.

Le t'i marrim gjërat një nga një: 1. Në pikën 75 të përmbledhjes së asaj që u lexua gjatë shqiptimit të aktgjykimit thuhet: “*Trupi Gjykues konstatoi se të katër të akuzuarit dhe persona të tjerë në udhëheqjen e UÇK-së, përfshirë ata që pretendohet se janë anëtarë të NKP-së, kishin dy objektiva: pavarësinë e Kosovës dhe vendosjen e kontrollit politik dhe institucional mbi atë që shpresonin se do të ishte një Kosovë e pavarur. Këto objektiva synojnë të realizoheshin me anë të mjeteve ushtarake, politike dhe tjera. Trupi Gjykues nuk e gjykoj të nevojshme të përcaktonte nëse këto dy objektiva ishin, në vetvete, kriminale apo të paligjshme.*” (Nënvizimi im).

Nuk e di nëse ndonjë trup tjetër gjykues do të dinte ta formulonte mohimin e jurisprudencës ndërkombëtare për çështjen e pavarësisë së Kosovës dhe vendosjes së kontrollit politik, në mënyrë më perfide, sesa arsyetimi se “*Trupi Gjykues nuk e gjykoj të nevojshme të përcaktonte nëse këto dy objektiva ishin, në vetvete, kriminale apo të paligjshme.*”

Jurisprudenca ndërkombëtare rreth ligshmërisë së pavarësisë së Kosovës

Më 8 tetor 2008, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi rezolutën, përmes së cilës kërkoi që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të japë mendim konsultativ lidhur me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës. Konkretisht, kësaj gjykatë iu kërkua që t'i përgjigjej pyetjes: “A është në pajtim me të drejtën ndërkombëtare shpallja e njëanshme e Pavarësisë së Kosovës nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes së

Kosovës?”.

Të nesërmen, më 9 tetor, kërkesa iu dërgua kryetarit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Më 22 korrik të vitit 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND në vijim të tekstit) shpalli vendimin.

Fillimisht GJND-ja e shqyrtoi aktin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në raport me të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare.

Në argumentimin e vet rreth kësaj çështjeje, GJND-ja solli faktet, se “*shpalljet e pavarësive ishin të shpeshta gjatë shekujve XVIII, XIX dhe XX, të cilat shpesh u shoqëruan me reagime të ashpra të shteteve nga të cilat ndaheshin. Disa prej këtyre shpalljeve rezultuan me krijimin e shteteve të reja, ndërsa disa të tjera jo. Në përgjithësi, në praktikën e shteteve, shpallja e pavarësisë së një shteti nuk konsiderohet si shkelje e së drejtës ndërkombëtare. Përkundrazi, nga praktika e shteteve të kësaj periudhe del qartazi, se e drejta ndërkombëtare nuk i ndaloj assesi shpalljet e pavarësive.*”

Në të njëjtin paragraf, GJND-ja sjell shembullin e krijimit të shumë shteteve të reja gjatë periudhës së dytë të shekullit XX dhe thekson: “*E drejta ndërkombëtare kishte ndryshuar shumë, sidomos në raport me vetëvendosjen e popujve të shtypur, të dominuar dhe të shfrytëzuar.*”

Përveç këtyre rasteve, që lidhen me periudhën e antikolonializmit, GJND-ja përmend edhe faktin e krijimit të shteteve jashtë këtij konteksti historik. “*Dhe nga tërë praktika e shteteve, nuk del një rregull e re e së drejtës ndërkombëtare, që do ta ndalonte shpalljen e pavarësisë.*”

GJND-ja u përgjigjet edhe atyre që pohojnë, se gjoja “*ndalimi i shpalljes së pavarësive përfshihet në parimin e integritetit territorial të shteteve.*” Sa i përket kësaj çështjeje, GJND-ja theksoi se në rastet kur Këshilli i Sigurimit i OKB-së i kishte dënuar shpalljet e pavarësive të vendeve të caktuara, “*këtë e kishte bërë jo për arsye se ato ishin shpallur të pavarura në mënyrë të njëanshme, por për shkak të përdorimit të dhunës apo të shkeljeve të rënda të normave të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare.*”

Pasi shqyrtoi të gjitha argumentet që kishin të bënin me këtë aspekt të kërkesës së shtruar në emër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe duke konstatuar se e drejta e përgjithshme ndërkombëtare nuk përmbante asnjë pengesë për të shpallur pavarësinë, GJND-ja shpalli përfundimin e vet: “*deklarata e Pavarësisë së Kosovës, e datës 17 shkurt 2008, nuk e ka shkelur të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare.*”

Në vijim të vendimit të GJND-së, paragrafi 85-121, shqyrtohet përputhshmëria e aktit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës me Rezolutën 1244 të Këshillit të

Sigurimit dhe me Kornizën Kushtetuese të Kosovës.

GJND-ja përsëriti faktin, se Rezoluta 1244 përbënte bazën juridike të vendosjes në Kosovë të misionit civil ndërkombëtar, UNMIK-u, dhe atij të sigurisë, KFOR-i, që kishin për qëllim krijimin e kushteve të sigurisë së nevojshme, mbikëqyrjen e procesit të krijimit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes autonome dhe demokratike, duke pritur një zgjidhje politike (Rezoluta 1244, paragrafi 11). Përmbajtja e Rezolutës 1244 dëshmon se Këshilli i Sigurimit nuk e përcaktonte statusin final të Kosovës dhe kjo rezolutë nuk përmbante asnjë pengesë për të shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008.

Për këtë arsye, “*gjykata doli në përfundimin, se rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit nuk paraqiste pengesë që autorët e deklaratës së 17 shkurtit 2008 ta shpallin Pavarësinë e Kosovës nga Republika e Serbisë dhe, rrjedhimisht, deklarata e pavarësisë nuk e ka shkelur rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit.*”

Në fund të vendimit të vet, GJND-ja trajton përputhshmërinë e aktit të shpalljes së Pavarësisë me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Për këtë çështje, ajo sjell faktet e përmendura nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në raportin⁴ e tij, se “*në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007, të cilat u cilësuan nga të gjithë vëzhguesit ndërkombëtarë si të drejta dhe demokratike, Kosova krijoi institucionet e saj qendrore dhe lokale.*”

Kuvendi i Kosovës, i krijuar në seancat e 4 dhe 9 janarit 2008, hodhi bazën legjitime dhe “*Akti i miratimit të deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, nuk e ka shkelur as të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, as Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe as Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Prandaj, miratimi i kësaj deklarate nuk ka bërë shkeljen e asnjë rregulle të aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare.*”

Të vetëdijshtëm se në disa raste që përmenden në vendimin e GJND-së Këshilli i Sigurimit i OKB-së i kishte dënuar shpalljet e pavarësive të vendeve të caktuara, “*jo për arsye se ato ishin shpallur të pavarura në mënyrë të njëanshme, por për shkak të përdorimit të dhunës apo të shkeljeve të rënda të normave të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare,*” në pikën 80 të përmbledhjes së asaj që u lexua gjatë shqiptimit të aktgjykimit thuhet:

80.

Nuk janë qëllimet të cilat të akuzuarit u përpoqën të arrinin ato që i bënë veprimet e tyre kriminale. Janë mjetet me të cilat ata u përpoqën t'i realizonin ato qëllime, veçanërisht arrestimi, ndalimi, keqtrajtimi dhe vrasja sistematike e atyre që të akuzuarit i konsideronin apo i cilësonin si kundërshtarë.

Prandaj pretendimi i Çarls L. Smith III, Kryegjykatës, gjykatësit Kristof Barte, Ginel Metro, Fergal Gejnor dhe gjykatësve rezervë të Trupit Gjykues se gjoja “*nuk e kanë parë të nevojshme të përcaktonin nëse qëllimi për pavarësinë e Kosovës ishte në vetvete kriminal apo i paligjshëm*” është mohim i jurisprudencës ndërkombëtare rreth kësaj çështjeje dhe përpjekje për të krijuar precedent që mund të shërbejë për të dënuar shpalljet e pavarësisë së Kosovës, “për shkak të përdorimit të dhunës apo të shkeljeve të rënda të normave të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare”

Jurisprudenca ndërkombëtare rreth vendosjes së kontrollit politik

Çështja e vendosjes së kontrollit politik u shqyrta në rastin e Këshillit Revolucionar të Forcave të Armatosura të Sierra Leones. Me kërkesë të qeverisë së Sierra Leones, më 14 gusht 2000, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1315 për themelimin e Gjykatës Speciale, për të gjykuar krimet kundër njerëzimit dhe shkeljet e rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare, që ishin bërë në këtë shtet që nga muaji nëntor 1996.

Në aktakuzën kundër rebelëve të Këshillit Revolucionar të Forcave të Armatosura që përmbysën regjimin e presidentit Ahmad Tejan Kabbah, në vitin 1997, prokurori i cilësoi si “*Ndërmarrje kriminale e përbashkët*”, me arsyetim se “*kanë dashur të vendosin pushtetin e tyre politik dhe kontrollin mbi tërë territorin e Sierra Leones, sidomos në zonat ku ishin minierat e diamantit.*” Mirëpo, në aktvendimin përfundimtar, gjykata hodhi poshtë pretendimet e prokurorit për t'i cilësuar si pjesëtarë të një “*Ndërmarrjeje kriminale të përbashkët*” dhe solli vendimin se, “*marrja e pushtetit politik dhe vendosja e kontrollit mbi tërë territorin e Sierra Leones, sidomos në zonat ku ishin minierat e diamantit, nuk përbën qëllim kriminal sipas statutit të Gjykatës Ndërkombëtare. Në të Drejtën Ndërkombëtare nuk ekziston asnjë normë që ndalon kryengritjen.*”

Disa vite përpara se të ngrinte aktakuzë kundër pjesëtarëve të UÇK-së, Carla Del Ponte ishte në dijeni të rrjedhave të procesit gjyqësor në Gjykatën Speciale të

Sierra Leones dhe të dështimit të plotë që përjetoi prokurori, i cili u përpoq të përdorte konceptin “*Ndërmarrje kriminale e përbashkët*” në aktakuzën kundër rebelëve të Këshillit Revolucionar të Forcave të Armatosura në atë shtet. Në vend që të kishte parasysh jurisprudencën e kësaj gjykatë, ajo u përpoq të përdorte të njëjtin koncept kundër pjesëtarëve të UÇK-së.

Në aktakuzat kundër Fatmir Limajt, Haradin Balajt, Isak Musliut, Ramush Haradinajt, Lahi Brahimaajt dhe Idriz Balajt, përfshirja nga ana e Carla Del Ponte-s e terminologjisë së përdorur nga Shërbimi Sekret i Serbisë në funksion të shtrembërimit të qëllimit politik të luftës çlirimtare, e bën ish-Prokuroren e Përgjithshme të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë pjesë të Ndërmarrjes së përbashkët, që synonte kriminalizimin e projektit politik të çlirimit të Kosovës. Mirëpo përpjekja e kësaj Ndërmarrjeje të përbashkët për të kriminalizuar luftën tonë dështoi, sepse: në të dy proceset gjyqësore të lartpërmendura, vendimet përfundimtare shpallën pafajësinë e plotë të Fatmir Limajt dhe Ramush Haradinajt dhe e hodhën poshtë si të pabazuar pretendimin për ta prezantuar UÇK-në si “*Ndërmarrje kriminale e përbashkët*”.

Në dy procese gjyqësore në Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, u hodh poshtë përpjekja për të shtrembëruar qëllimin e projektit politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Prandaj pretendimi i Çarls L. Smith III, Kryegjykatës, gjykatësit Kristof Barte, Ginel Metro, Fergal Gejnor dhe gjykatësve rezervë të Trupit Gjykues se gjoja “*nuk e kanë parë të nevojshme të përcaktonin nëse qëllimi për të vendosur kontrollin politik dhe institucional mbi atë që shpresonin se do të ishte një Kosovë e pavarur ishte në vetvete kriminal apo i paligjshëm*” është mohim i jurisprudencës ndërkombëtare rreth kësaj çështjeje dhe përpjekje për të krijuar precedent që mund të shërbejë për të përkufizuar ndryshe natyrën e luftës sonë çlirimtare.

Pikërisht për këto arsye, përtej tragedisë individuale dhe familjare që po përjetojnë qe gjashtë vite Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi, vendimi i 16 shtatorit i ka ngulur thikën luftës çlirimtare të popullit shqiptar të Kosovës dhe pavarësisë së shtetit të Kosovës. Përballë kësaj situatë me rreziqe të mëdha, konsensusi i përgjithshëm politik, shoqëror dhe mbarëkombëtar është DOMOSDOSHMËRI.

KOMPANITË GJERMANE SHPREHIN INTERESIM PËR INVESTIME NË KOSOVË

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), Mimoza Kusari-Lila, ka zhvilluar takim me Klaus Nachtigall, ekspert i sigurisë me 37 vite përvojë në Gjermani dhe Kosovë, si dhe me Fitim Gashin nga BEAM Construction GmbH, kompani me seli në Mönchengladbach të Gjermanisë. Në takim është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet kompanive kosovare dhe gjermane, me fokus të

veçantë në investimet në Kosovë. Kusari-Lila ka bërë të ditur se gjatë takimit është diskutuar për mundësitë në fushën e energjisë së ripërtëritshme, zhvillimin e parqeve industriale dhe infrastrukturën moderne përcjellëse. Sipas saj, Kosova është e hapur për investime dhe ka kapacitete njerëzore, fuqi të re punëtore dhe potencial për zhvillim ekonomik. Në takim është diskutuar edhe për digjitalizimin e industrisë përmes eko-parqeve teknologjike, si dhe për sigurinë dhe mbrojtjen e të

dhënave digjitale, fusha në të cilat institucionet e Kosovës janë duke punuar. Ministria Kusari-Lila ka theksuar se agjenda e MINTI-t synon zhvillimin e një ekonomie ku teknologjia, inovacioni dhe ndërmarrësia krijojnë mundësi të reja dhe vende pune. Ajo ka vlerësuar gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit me partnerët gjermanë, veçanërisht me pjesëtarët e diasporës kosovare, përmes sjelljes së përvojës, dijes dhe kapitalit të ri në Kosovë.



NXËNËSIT NË GJAKOVË INFORMOHEN PËR BUJQËSINË ORGANIKE DHE PRODHIMET VENDORE

GJAKOVË, 18 SHTATOR - Nxënësit e shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë janë informuar për rëndësinë e bujqësisë organike, prodhimet vendore dhe mundësitë që ofron ky sektor për të rinjtë. Sesioni edukativ është organizuar nga shoqata “Organika”, në kuadër të fushatës “TokafoneShijaJuaj”, pjesë e projektit EREA, që synon promovimin e prodhimeve bujqësore vendore dhe informimin e të rinjve për sektorin e bujqësisë. Gjatë ligjëratës, drejtori ekzekutiv i shoqatës “Organika”, Faton



Nagavci, prezantoi karakteristikat e prodhimeve organike dhe rëndësinë e këtij sektori për fermerët,

konsumatorët dhe zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë në Kosovë. Nxënësit u informuan edhe për

mundësitë që ofron bujqësia organike, si dhe për rëndësinë e mbështetjes dhe konsumit të produkteve vendore. Një pjesë e sesionit iu kushtua procesit të certifikimit dhe etiketimit të produkteve organike, me ç'rast nxënësit morën informacione mbi mënyrën se si këto produkte prodhohen dhe identifikohen në treg. Interesimi i nxënësve nxiti diskutim rreth bujqësisë organike dhe rolit të saj në zhvillimin e ardhshëm të sektorit agro-ushqimor në Kosovë. Sipas organizatorëve, aktivitete të

tilla synojnë t'i afrojnë të rinjtë me sektorin e bujqësisë organike, duke i informuar për rëndësinë e prodhimit të qëndrueshëm, konsumit të produkteve vendore dhe mundësive profesionale që ofron ky sektor. Shoqata “Organika” ka falënderuar drejtuesit, profesorët dhe nxënësit e shkollës “Kadri Kusari” për bashkëpunimin dhe mikpritjen. Projekti EREA – Fuqizimi i Ekonomisë Rurale në Bujqësi zbatohet nga Caritasi Zviceran dhe financohet nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim.

AUV TËRHEQ NGA QARKULLIMI KONCENTRATIN PËR LOPË “SELECT MILK GR”

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ka njoftuar për tërheqjen nga përdorimi dhe qarkullimi të produktit “SELECT MILK GR”, pasi është konfirmuar tejkalmi i nivelit maksimal të lejuar të Aflatoksinës B1 (AFB1) në ushqimin për kafshë. Sipas AUV-së, bëhet fjalë për koncentratin për lopë qumështore “SELECT MILK GR”, i prodhuar nga kompania DE HEUS D.O.O. në Serbi dhe i importuar në Kosovë nga N.P.T. “Haxhijaha” SH.P.K., me bazë në Rahovec. “Produkti i konstatuar jokonform është koncentrat për lopë qumështore ‘SELECT MILK

GR’, i prodhuar nga DE HEUS D.O.O., Republika e Serbisë, dhe i importuar në Kosovë nga N.P.T. ‘Haxhijaha’ SH.P.K., Rahovec”, thuhet në njoftimin e AUV-së. AUV ka identifikuar dy lote të produktit, me numrat 0385010426007 dhe 0385020426001, për të cilat është urdhëruar tërheqja nga qarkullimi. “Është urdhëruar tërheqja e produktit, izolimi i sasive të mbetura dhe gjurmimi i shpërndarjes së tij deri te operatorët dhe fermat ku është përdorur”, njofton AUV. Agjencia u ka bërë thirrje fermerëve, distributorëve dhe operatorëve që e posedojnë këtë produkt që të mos e përdorin

apo vendosin në qarkullim. “AUV u bën thirrje fermerëve, distributorëve dhe operatorëve që posedojnë produktin ‘SELECT MILK GR’ nga LOT-et e identifikuar më sipër, të mos e përdorin dhe të mos e vendosin në qarkullim, ta mbajnë të veçuar dhe të bashkëpunojnë me AUV-në dhe operatorin përgjegjës për procedurën e tërheqjes”, thuhet në njoftim. Përveç tërheqjes së produktit, AUV ka njoftuar edhe për një masë të përkohshme parandaluese që do të jetë në fuqi për 30 ditë. Gjatë kësaj periudhe ndalohet importi i koncentrateve dhe përzjerjeve me bazë misri për



lopë qumështore dhe viça, të klasifikuara nën kodin tarifar 2309909600, me origjinë ose të prodhuara në Serbi. “Gjatë kësaj periudhe, AUV do të kryejë vlerësim të dokumentuar të rrezikut, mbi bazën e rezultateve laboratorike dhe kontroleve

zyrtare, për përcaktimin e masave të mëtejshme”, thuhet në njoftim. Ndërkohë, janë intensifikuar kontrollet për Aflatoksinën B1 në misër dhe produktet me bazë misri që përdoren si ushqim për kafshë, me fokus të veçantë te ushqimi për lopët qumështore. Sipas AUV-së, Aflatoksina B1 është një substancë toksike që mund të gjendet në misër dhe në ushqimin për kafshë. “Sipas vlerësimit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), aflatoksinat paraqesin shqetësim për shkak të efekteve toksike, gjenotoksike dhe kancerogjene, veçanërisht në mëlçi”, thuhet në njoftim.

Rizvanolli: Kosova po krijon mundësi të reja për investime në energjinë e ripërtëritshme

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, mori pjesë në Tryezën e Diskutimit “Si mund të tërheqë Kosova investitorë gjermanë në ankandet e ardhshme të energjisë së ripërtëritshme?”, të organizuar nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, në kuadër të projektit “Mbështetja e partneritetit për tranzicion klimatik dhe energjetik” të financuar nga GLZ. Në fjalën e saj hyrëse, ministria

Rizvanolli prezantoi zhvillimet e deritanishme në procesin e ankandave të energjisë së ripërtëritshme, duke theksuar rëndësinë e krijimit të një tregu konkurrues, transparent dhe të parashikueshëm për investitorët. Gjatë diskutimit, Rizvanolli foli për ecurinë e ankandave të para për energjinë diellore dhe të erës, përvojat gjatë këtyre proceseve, planet për ankandet e ardhshme, si dhe mundësitë

për forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e interesit të investitorëve gjermanë në sektorin e energjisë në Kosovë. Në këtë drejtim, ajo theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me Gjermaninë dhe të investimeve private për përshejtimin e zhvillimit të kapaciteteve të reja të energjisë së ripërtëritshme dhe avancimin e objektivave energjetike të vendit. Tryeza mblodhi përfaqësues të institucioneve publike, sektorit



privat, komunitetit ndërkombëtar, shoqërisë civile dhe ekspertë të fushës, ndërsa

diskutimi shërbeu edhe si përgatitje për Forumin Ekonomik Gjermano-Kosovar

DETI PO NDRYSHON HARTËN E EVROPËS: DHJETË QYTETET QË PËRBALLEN ME NJË TË ARDHMEN ‘KËRCËNUESE’



Evropa bregdetare po përballet me një ndryshim të rëndësishëm gjeografik, pasi rritja e nivelit të detit dhe fundosja graduale e tokës po ndryshojnë kushtet në shumë zona urbane.

Sipas analizave të paraqitura në një artikull të publikuar nga Studenti.it, ky nuk është më një kërcënim i largët, por një proces që tashmë po vë në provë infrastrukturën, trashëgiminë historike dhe sigurinë e miliona banorëve.

Nga metropolet që shtrihen përgjatë Detit të Veriut deri te qytetet historike të Mesdheut dhe Adriatikut, aftësia për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike do të jetë veçanërisht e rëndësishme në dekadat e ardhshme.

Artikulli rendit 10 qytete evropiane të ekspozuara ndaj rrezikut të përmbytjeve dhe rritjes së nivelit të ujit deri në vitin 2050.

Venecia është një nga shembujt më të njohur të rrezikut nga rritja e nivelit të detit.

Qyteti përballet njëkohësisht me rritjen e nivelit të Adriatikut dhe me fundosjen graduale të tokës, një proces i njohur si subsidence.

Sistemi i barrierave të

lëvizshme MOSE është ndërtuar për të mbrojtur qytetin nga fenomeni i “acqua alta”. Megjithatë, rritja e nivelit mesatar të detit mund të bëjë që barrierat të përdoren gjithnjë e më shpesh, duke krijuar sfida edhe për ekuilibrin ekologjik të lagunës.

Një pjesë e konsiderueshme e **Amsterdemit** dhe rajonit Randstad ndodhet nën nivelin e detit.

Qyteti mbrohet nga një sistem kompleks digash, polderësh, barrierash dhe pompash hidraulike.

Holanda konsiderohet një nga vendet me përvojën më të madhe në botë në menaxhimin e ujërave. Megjithatë, rritja e nivelit të Detit të Veriut dhe stuhitë më të forta mund të shtojnë presionin mbi infrastrukturën mbrojtëse.

Roterdami është një nga qytetet më të ekspozuara ndaj rrezikut të përmbytjeve, pasi një pjesë shumë e madhe e territorit të tij ndodhet nën nivelin e detit.

Qyteti, që ka një nga portet më të mëdha në botë, ndodhet në zonën ku bashkohen ndikimet e Detit të Veriut me sistemin lumor të Renit dhe Maas.

Roterdami ka investuar në projekte të reja për menaxhimin e ujërave,

përfshirë hapësira urbane që mund të grumbullojnë përkohësisht ujin e shiut dhe infrastruktura të konceptuara për t'u përshtatur me përmbytjet.

I shtrirë përgjatë grykëderdhjes së lumit Elba, **Hamburgu** është i ekspozuar ndaj stuhive të forta të Detit të Veriut.

Valët e stuhive mund të depërtojnë përmes grykëderdhjes së Elbës dhe të rrisin nivelin e ujit në qytet.

Zona historike dhe pjesë të zhvillimeve moderne urbane, përfshirë HafenCity, kërkojnë masa të vazhdueshme mbrojtëse kundër përmbytjeve.

Bordo ndodhet në brigjet e lumit Garonë, i cili lidhet me Oqeanin Atlantik përmes grykëderdhjes së Girondës.

Rritja e nivelit të detit, së bashku me baticat dhe fenomenet ekstreme të motit, mund të shtojë rrezikun e përmbytjeve në zonat e ulëta urbane dhe në territoret përreth.

I njohur si “Venecia e Veriut”, **Bryzh** është një qytet historik i përshkuar nga kanale dhe pjesë e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Qyteti ndodhet në një fushë bregdetare me lartësi shumë të

ulët, duke e bërë të ndjeshëm ndaj rritjes së nivelit të Detit të Veriut.

Përveç përmbytjeve, rritja e nivelit të ujit mund të favorizojë edhe depërtimin e ujit të kripur në zonat bregdetare.

I ndërtuar në deltën e lumit Neva, në Gjirin e Finlandës, **Shën Petersburgu** ka një histori të gjatë përmbytjesh.

Për të mbrojtur qytetin është ndërtuar një sistem i madh digash dhe barrierash, i përfunduar në vitin 2011.

Megjithatë, rritja e nivelit të detit dhe ndryshimet në intensitetin e stuhive në Detin Baltik mund të shtojnë rrezikun e përmbytjeve në të ardhmen.

Gdansk, i vendosur në brigjet e Detit Baltik dhe pranë grykëderdhjes së Vistulës, ka zona urbane dhe industriale me lartësi të ulët mbi nivelin e detit. Përmbytjet bregdetare, erozioni dhe ndryshimet në transportin natyror të sedimenteve e bëjnë Gjirin e Gdanskut një nga zonat që kërkojnë vëmendje të veçantë në Evropën Lindore.

Edhe pse ndodhet në brendësi të Gadishullit Iberik, Sevilja lidhet me ndikimin e Atlantikut përmes lumit Guadalquivir.

Rritja e nivelit të detit, e kombinuar me reshje intensive,

përmbytje të menjëhershme dhe prurje të mëdha lumore, mund të rrisë rrezikun për zonat e ulëta të qytetit.

Përveç Venecias, bregdeti i Adriatikut të sipërm është ndër zonat e ndjeshme ndaj rritjes së nivelit të ujit.

Ravenna dhe zonat e saj bregdetare përballet me një kombinim faktorësh, përfshirë fundosjen e tokës, erozionin bregdetar dhe rritjen e nivelit të detit.

Në disa zona, subsidence është lidhur edhe me shfrytëzimin historik të ujërave nëntokësore dhe gazit. Zonat e ulëta, përfshirë lagunat, kënetat dhe sipërfaqet e kripura përreth qytetit, konsiderohen veçanërisht të ekspozuara.

Rasti i këtyre qyteteve tregon se rreziku nuk varet vetëm nga distanca prej detit, por edhe nga lartësia e territorit, fundosja e tokës, prania e lumenjve, sistemet e mbrojtjes dhe intensiteti i fenomeneve ekstreme të motit.

Ekspertët e klimës theksojnë se përshtatja urbane, mbrojtja e infrastrukturës dhe planifikimi afatgjatë do të jenë vendimtare për qytetet bregdetare evropiane, ndërsa niveli i deteve vazhdon të rritet.

GJERMANIA RIKTHEN BUNKERËT E LUFTËS SË FTOHTË DHE PËRGATIT SPITALET NË RAST KONFLIKTI ME RUSINË

Gjermania po përgatit sistemin shëndetësor për një skenar lufte, duke marrë masa që përfshijnë rikthimin në funksion të bunkerëve të ndërtuar gjatë Luftës së Ftohtë, trajnimin e kirurgëve civilë për plagë luftarake dhe mbrojtjen e spitaleve nga sulmet me dronë. Një reportazh i gjerë i Bloomberg, me titullin “Germany’s Hospitals Prepare for War and Mass Casualties as Russia Threat Looms”, përshkruan mënyrën se si spitalet gjermane po planifikojnë të përballojnë një situatë të mundshme konflikti në Evropë. Për dekada, në Gjermani mbizotëroi ideja se lufta ishte një realitet që i përkiste vendeve të tjera, por kjo qasje po ndryshon. Përveç diskutimeve për riarmatimin, raketat dhe tanket, autoritetet dhe strukturat shëndetësore po përballen tashmë me pyetje konkrete: sa të plagosur mund të duhet të trajtohen, sa shtretër dhe kirurgë do të nevojiten dhe si do të funksionojnë spitalet nëse dëmtohen rrjetet e energjisë apo komunikimit. Një shembull i përmendur është spitali i Ulmit, ku nën ndërtesën e tij ndodhet një bunker i ndërtuar në vitin 1979,

i projektuar për të trajtuar ushtarë të plagosur edhe pas një sulmi bërthamor. Bunkeri mund të strehojë deri në 2 mijë persona për një periudhë prej 90 ditësh dhe pas dekadash i papërdorur, tani ushtria gjermane po shqyrton rikthimin e tij në funksion. Pesë spitalet ushtarake të Gjermanisë nuk do të ishin të mjaftueshme për të përballuar një konflikt në shkallë të gjerë, ndaj spitalet civile do të duhej të luanin një rol shumë më të madh. Në fokus janë procedurat e triazhit, trajtimi i plagëve të luftës, rezervat e ilaçeve dhe gjakut, numri i shtretërve, komunikimet dhe funksionimi i spitaleve në kushte të degraduara. Gjithashtu po shqyrtohen masa për mbrojtjen e spitaleve nga sulmet me dronë, përfshirë barriera mbrojtëse dhe xhama të blinduar, si dhe planifikimi i punës gjatë një blackout-i të gjerë ose ndërprerjes së infrastrukturës kritike. Një tjetër pjesë e përgatitjeve është trajnimi i kirurgëve civilë për trajtimin e plagëve të shkaktuara në luftë dhe për menaxhimin e situatave me një numër jashtëzakonisht të madh pacientësh, të njohura si “mass casualty events”. Sipas të dhënave të përmendura, në



Gjermani janë vetëm disa qindra mjekë me përvojë specifike në trajtimin e plagëve tipike të luftës, çka e bën trajnimin e personelit civil një element kyç. Përgatitjet nuk kufizohen vetëm te spitalet, por përfshijnë edhe rihapjen e bunkerëve të Luftës së Ftohtë, krijimin e rezervave të materialeve dhe ilaçeve, mbrojtjen e objekteve shëndetësore nga dronët, organizimin e evakuimit të të plagosurve dhe planifikimin e transportit mjekësor. Në këtë kuadër po diskutohet koordinimi më i ngushtë mes Bundeswehr-it dhe sistemit

civil shëndetësor. Një raport i Bundeswehr-it modeloi skenarë të mundshëm për një sulm rus ndaj NATO-s, duke vlerësuar se Gjermania mund të pranonte deri në 1,000 ushtarë të plagosur në ditë, gjë që do të mbingarkonte shpejt spitalet ushtarake dhe do të vendoste spitalet civile nën presion të paparë. Sfidat e qeverisë përfshijnë gjetjen e mjaftueshme të shtretërve spitalorë, forcimin e zinxhirëve të furnizimit mjekësor dhe përmirësimin e koordinimit midis spitaleve ushtarake dhe civile. Trajnimi i mjaftueshëm i personelit mjekësor është një

tjetër sfidë urgjente. Kompanitë private në sektorin e kujdesit shëndetësor janë të shqetësuara se punonjësit e tyre mund të thirren si rezervistë ose të shërbejnë si vullnetarë për shërbim ushtarak, gjë që prek deri në 20% të punonjësve në disa rajone. Gjermania ka parë një rritje të sulmeve hibride që kur Rusia nisi pushtimin e saj të plotë të Ukrainës në vitin 2022, përfshirë një incident me një dron që mbante eksplozivë në Aeroportin e Leipzigut. Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, ka thënë se Rusia mund të fillojë një luftë me NATO-n në vitin 2029, megjithëse disa analistë besojnë se kjo mund të ndodhë edhe më shpejt. Në këtë rast, Gjermania do të ishte e detyruar të mbronte aleancën dhe, për shkak të vendndodhjes së saj gjeografike, ka të ngjarë të bëhej një qendër kryesore tranziti për personelin ushtarak. Ekspertët paralajmërojnë se sistemi shëndetësor gjerman nuk është i përgatitur për një konflikt të madh, ndërsa drejtuesit e spitaleve e përshkruajnë sfidën si një “maratonë” që kërkon investime të mëdha në modernizimin e infrastrukturës dhe furnizimeve.

EL NIÑO DHE NGROHJA GLOBALE MË SHUMË NXEHTËSI, MË SHUMË LAGËSHTI. AVUJT E UJIT ARRIJNË NIVEL REKORD NË ATMOSFERË

Atmosfera e Tokës përmbajti në gusht sasinë më të lartë të avujve të ujit të regjistruar ndonjëherë, duke rritur rrezikun për valë të forta të nxehtit dhe reshje ekstreme në pjesë të ndryshme të botës. Të dhënat e reja vijnë nga Shërbimi i Ndryshimeve Klimatike i programit evropian Copernicus (C3S). Shkencëtarët thonë se ngrohja globale ka ndikuar në këtë rekord, pasi një atmosferë më e ngrohtë është në gjendje të mbajë më shumë lagështi. Në të njëjtën kohë, fenomeni El Niño në Oqeanin Paqësor mendohet se ka kontribuar në rritjen e sasisë së avujve të ujit. Sipas të dhënave të C3S, gjatë muajit gusht sasia e avujve të ujit në atmosferë arriti në 27.35 kilogramë për metër katror. Kjo vlerë tejkaloi rekordin e mëparshëm, të regjistruar në korrik të vitit 2024, me 0.04 kilogramë për metër katror. Shifra tregon sasinë e avujve të ujit që ndodhen në një kolonë ajri mbi një metër katror të sipërfaqes së Tokës, duke u shtrirë përgjatë gjithë atmosferës. Sipas një përlllogaritjeje të shkencëtarëve, rritja prej 0.04 kg/m² në krahasim me rekordin e mëparshëm është e barasvlershme me rreth 20 trilionë litra ujë shtesë në atmosferë.



Atmosfera më e ngrohtë mban më shumë lagështi

Julien Nicolas, shkencëtar i lartë në C3S, tha se rekordi për avujt e ujit është në përputhje me temperaturat jashtëzakonisht të larta globale të regjistruara gjatë gushtit. Sipas tij, ajri mund të mbajë rreth 7% më shumë avuj uji për çdo një gradë Celsius ngrohje globale. Oqeanet tropikale janë ndër burimet kryesore të avujve të ujit në atmosferë. Temperaturat jashtëzakonisht të larta të sipërfaqes së detit në këto rajone gjatë gushtit, pjesërisht

të lidhura me forcimin e kushteve të El Niño-s, kanë rritur avullimin dhe mendohet se kanë ndikuar në rekordin e ri.

Më shumë avuj uji, më shumë rrezik për reshje ekstreme

Rritja e sasisë së avujve të ujit në atmosferë mund të ndikojë në intensitetin e reshjeve, përfshirë ato të lidhura me ciklonet dhe stuhi të fuqishme. Kur avujt e ujit kondensohen dhe shndërrohen në pika uji brenda reve, çlirohet nxehtësi. Kjo energji mund të kontribuojë në forcimin e stuhive.

Shkencëtarët paralajmërojnë gjithashtu se lagështia e lartë mund t'i bëjë valët e të nxehtit më të rrezikshme, pasi pengon ftohjen gjatë natës dhe e bën më të vështirë rikuperimin e organizmit pas ditëve me temperatura shumë të larta.


Gushti, ndër muajt më të nxehtë të regjistruar

Gushti ishte gjithashtu ndër muajt më të nxehtë të regjistruar ndonjëherë, sipas të dhënave të ERA5 të Copernicus, të cilat shkojnë deri në vitin 1940. Ndërkohë, të dhënat e administratës amerikane NOAA, që kanë një seri matjesh

që nis në vitin 1850, e renditën gushtin si muajin më të nxehtë të regjistruar në historinë e kësaj serie. Shkencëtarët e lidhin këtë prirje me emetimet e gazeve serrë nga djegia e lëndëve djegëse fosile, ndërsa El Niño po ashtu luan një rol në rritjen e temperaturave globale.

Një cikël që mund të përforcojë ngrohjen

Avujt e ujit janë vetë një gaz serrë dhe luajnë rol në sistemin klimatik të Tokës. Sa më shumë të ngrohet atmosfera, aq më shumë avuj uji mund të mbajë ajo. Kjo lagështi shtesë kontribuon më tej në efektin serrë dhe mund të përforcojë ngrohjen. Shkencëtarët theksojnë se, megjithëse rekordi i ri për sasinë e avujve të ujit mund të duket i vogël në terma absolutë, rritja e vazhdueshme e lagështisë atmosferike mund të ketë pasoja të rëndësishme për temperaturat ekstreme, reshjet dhe stuhitë. Fenomeni aktual El Niño në Paqësorin tropikal pritet të jetë ndër episodet më të forta të regjistruara, ndërsa shkencëtarët paralajmërojnë se ai mund të ndikojë në temperaturat globale edhe gjatë vitit të ardhshëm.



Hoxha largohet nga Dinamo, kalon te Al Wahda

ZAGREB, 18 SHTATOR - Aventura e Arbër Hoxhës te Dinamo Zagrebi duket se ka marrë fund. Sulmuesi anësor pritet të largohet nga futbolli kroat për të vazhduar karrierën në Emiratet e Bashkuara Arabe, raportojnë mediet kroate.

Hoxha pritet të transferohet te Al Wahda, pasi raportohet se marrëveshja mes të gjitha palëve tashmë është arritur. Dinamo Zagrebi pritet të përfitojë 2.5 milionë euro nga shitja e Hoxhës, plus bonuse, ndërsa klubi kroat do të mbajë edhe 10 për qind të

kartonit të tij për një shitje të ardhshme. Finalizimi i marrëveshjes dhe zyrtarizimi i transferimit te Al Wahda është vetëm çështje kohe dhe mund të ndodhë para se Hoxha t'i bashkohet grumbullimit me Kombëtaren e Shqipërisë. Hoxha ishte pjesë e

Dinamos që nga viti 2024, kur iu bashkua klubit nga Slaven Belupo. Gjatë karrierës në Kroaci, ai ka luajtur edhe për Lokomotivën e Zagrebit. Në sezonin aktual, Hoxha ka shënuar dy gola në 12 paraqitje për Dinamon në të gjitha garat.



FODA PUBLIKON LISTËN ZYRTARE TË KOSOVËS, SHUMË RISI DHE MUNGESA TË MËDHA

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Përzgjedhësi i Kosovës, Franco Foda, ka publikuar listën zyrtare të futbollistëve të ftuar për ndeshjet e ardhshme të Ligës së Kombeve, ku "Dardanët" do të zhvillojnë katër përballje në kuadër të një periudhe të ngjeshur ndërkombëtare. Në listën prej 27 futbollistësh ka disa risi, me Dion Kacurin dhe Erblin Osmanin që janë ndër emrat më të komentuar. Kacuri, i cili më herët ka përfaqësuar grupmoshat e Zvicrës, tashmë është pjesë e listës së Kosovës, ndërsa 17-vjeçari Erblin Osmani, pjesë e akademisë së Bayern Munichut dhe më herët i angazhuar me grupmoshat e Gjermanisë, është ftuar për herë të parë në Kombëtaren A. Foda ka vendosur të llogarisë edhe në disa emra të rinj si Vesel Demaku, Donat Rudhani, Valmir Matoshi,



Muharrem Jashari, Lindon Emërllahu, Leon Avdullahu e Fisnik Asllani.

Në listë janë edhe yjet kryesorë të "Dardanëve", Edon Zhegrova, Milot Rashica dhe Vedat Muriqi, ndërsa Ermal Krasniqi,

Albion Rrahmani, Baton Zabërgja dhe Fisnik Asllani kompletojnë repartin ofensiv.

Lista vjen në një moment të veçantë për Kombëtaren, pasi kapiteni Amir Rrahmani ka njoftuar se nuk do të jetë pjesë

e Kosovës, ndërsa Florent Hadërgjonaj ka bërë të bërë me dije se për momentin nuk do të luajë për "Dardanët" në drejtimin e stafit aktual teknik. Hadërgjonaj ka theksuar se vendimi i tij nuk përbën tërheqje nga Kombëtarja. Në listë mungon gjithashtu Kreshnik Hajrizi, i cili është përballur me probleme fizike, ndërsa Foda ka rikthyer disa prej lojtarëve që kanë qenë më

pak të pranishëm në grumbullimet e fundit.

Kosova do ta nisë këtë seri ndeshjesh më 24 shtator në Prishtinë ndaj Irlandës, përpara udhëtimit në Vjenë për përballjen me Austrinë më 27 shtator.

Më 1 tetor, "Dardanët" do të përballen me Izraelin, ndërsa katër ndeshjet do t'i mbyllin më 4 tetor në Prishtinë ndaj Austrisë.

LISTA ZYRTARE E KOSOVËS:

PORTIERË: Arijanet Muriç, Amir Saiqi dhe Visar Bekaj.

MBROJTËS: Mërgim Vojvoda, Lumbardh Dellova, Ilir Krasniqi, Alban Hajdari, Ron Raçi, Leard Sadriu dhe Dion Gallapeni.

MESFUSHORË/SULMUES: Ermal Krasniqi, Milot Avdyli, Baton Zabërgja, Veldin Hoxha, Vesel Demaku, Erblin Osmani, Lindon Emërllahu, Leon Avdullahu, Dion Kacuri, Donat Rudhani, Muharrem Jashari, Valmir Matoshi, Milot Rashica, Edon Zhegrova, Fisnik Asllani, Albion Rrahmani dhe Vedat Muriqi.


LISTA E ZGJERUAR: Faton Maloku, Bledian Krasniqi, Kreshnik Krasniqi, Florian Haxha, Betim Fazliji, Andi Hoti, Leon Frrokaj, Rifind Nivokazi, Meriton Korenica dhe Faton Ademi.

VALON BERISHA DHE FIDAN ALITI PENSIONOHEN NGA KOMBËTARJA E KOSOVËS

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Futbollistët Valon Berisha dhe Fidan Aliti janë pensionuar zyrtarisht nga Kombëtarja e Kosovës. Lajmin e ka bërë me dije Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), përmes dy njoftimeve të ndara. Berisha dhe Aliti kanë qenë për vite me radhë pjesë e rëndësishme e Kombëtares së Kosovës, duke qenë pjesë e gjeneratës që përfaqësoi vendin në garat ndërkombëtare. Berisha, i cili ka zhvilluar 52 ndeshje me fanellën e Kosovës dhe ka shënuar disa gola, përfshirë atë ndaj Finlandës, ka

bërë të ditur se ka ardhur koha ta përfundojë periudhën e tij si futbollist aktiv me Kombëtaren. Në mesazhin e tij, Berisha ka kujtuar vendimin për t'iu bashkuar Kosovës, duke theksuar se pavarësisht mirënjohjes ndaj Norvegjisë, zgjedhi ta përfaqësojë vendin e tij dhe të jetë pjesë e ndërtimit të Kombëtares.

Ai ka falënderuar familjen, bashkëlojtarët, trajnerët, stafin, FFK-në dhe tifozët, duke theksuar se edhe pse nuk do të jetë më në fushë, do të mbetet gjithmonë përkrahës i Kosovës.



"Sepse, kur, një herë e ke veshur këtë fanellë, ajo nuk hiqet më kurrë prej teje", është thënë në mesazhin e Berishës.

Mesazhin e tij, Berisha e ka përmbyllur mesazhin me fjalët: "Të dua, Kosova ime!".

Edhe Fidan Aliti ka njoftuar për mbylljen e kapitullit të tij me Kombëtaren e Kosovës, duke e cilësuar vendimin si një prej më të vështirëve.

Aliti ka deklaruar se veshja e fanellës së Kosovës ka qenë dhe do të mbetet një prej nderimeve më të mëdha të jetës së tij. Ai ka kujtuar emocionet, sakrificat, fitoret dhe humbjet e përjetuara me Kombëtaren.

Mbrojtësi është shprehur veçanërisht krenar që ka qenë

pjesë e gjeneratës që hapi kapitullin e Kosovës në garat ndërkombëtare.

Ai ka falënderuar bashkëlojtarët, trajnerët, stafin, FFK-në dhe tifozët, ndërsa falënderim të veçantë i ka kushtuar familjes së tij për mbështetjen gjatë gjithë karrierës. "Sot po largohem nga Kosova si futbollist, por kurrë si tifoz i saj. Kosova është dhe do të jetë gjithmonë pjesë e imja", ka theksuar Aliti.

Ai e ka përmbyllur mesazhin me fjalët: "Faleminderit për gjithçka, Kosovë. Ishte ëndërr, u bë nder dhe krenari".

Portugalia fton Cristiano Ronaldon për Ligën e Kombeve

LISBONË, 18 SHTATOR - Cristiano Ronaldo do të jetë pjesë e Kombëtares së Portugalisë për ndeshjet e Ligës së Kombeve. Ronaldo është përfshirë në mesin e 25 futbollistëve të ftuar nga përzgjedhësi i ri i

Portugalisë, Jorge Jesus, i cili të premten ka publikuar listën. Sulmuesi i Al-Nassrit raportohet se po e konsideronte pensionimin nga Kombëtarja pas Kupës së Botës 2026, por ai është ftuar sërish

nga Portugalia. Kjo do të jetë gjithashtu hera e parë që Jorge Jesus do ta drejtojë Portugalinë në një ndeshje zyrtare. Portugalia do t'i zhvillojë katër ndeshje në kuadër të Grupit A4 të Ligës së Kombeve, ku do të

përballen me Uellsin, Norvegjinë dhe Danimarkën. Ronaldo, 41-vjeçar, do të jetë kapiten i Portugalisë, për të cilën ka regjistruar 233 paraqitje dhe ka shënuar 146 gola.





N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë - Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinese.com
www.pallatirinese.com



Në bazë të dispozitave të nenit 21, pikës 21.4 të Ligjit nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, gjegjësisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 17 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me datë 11.09.2026 bazuar mbi Vendimin Nr. 1/2058 publikon këtë:

KONKURS PUBLIK Për plotësimin e një (1) pozite

1. Titulli i punës: Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e Vendi: Prishtinë.

Ndërmarrja: N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve.
Mandati: 3 vite
Koeficienti: 5.9

2. Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve, dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t'i përmbushë edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale në vijim:

- Të posedojë diplomë universitare -Fakulteti Juridik (jurist i diplomuar ose master në shkenca juridike);
- Të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 neni 13;
- Aftësi për punë ekipore;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Të ketë etikë në punë dhe integritet.
- Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);
- Dëshmitë mbi njohuritë dhe të arriturat tjera do të mirren në konsideratë dhe vlerësohen konform relevancës me vendin e punës;
- Të jetë person me integritet të lartë dhe të plotësojë të gjitha kushtet e përshtatshmërisë të parapara me neni 17 të Ligjit të Ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 , dhe plotësim ndryshimit përkatës,Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit public nr/06L-011, si dhe me normat tjera positive relevante.

3. Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Sigurohet që të përcillen procedurat e Bordit, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe Aksionarëve duke përfshirë (në bashkëpunim me Kryesuesin) përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave;
- Mban regjistrin e aksionarëve;
- Koordinon me KE përgatitjen e materialit për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Mban procesverbalin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesit e tyre) dhe i regjistron në librat e protokolleve;
- Shpërndan procesverbalet tek drejtorët dhe aksionarët;
- Merret me regjistrimin zyrtar të ndryshimeve të cilat kërkohen sipas ligjit, i regjistron në regjistrin e Kosovës për shoqëritë tregtare dhe emrat tregtarë;
- Sipas udhëzimeve nga Kryesuesi, përgjegjësitë e Sekretarit përfshijnë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit dhe komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndërmarrjes;
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve i cili njëheri është përgjegjës tek Bordi për të siguruar që përputhen procedurat e Bordit;
- Përcjell ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe menaxhmentin e kompanisë për ndryshimet si dhe përgatitë udhëzimet e nevojshme për menaxhmentin e kompanisë.Merret edhe me çështjet tjera të qeverisjes korporative sipas nevojës.

4. Informatë për procedurën e konkurimit

- Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
- Formulari i kërkesës për punësim (aplikimit);
- Kopje e letërnjoftimit; CV ; Çertifikata e lindjes;Letër motivimi;
- Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin profesional e noterizuar;
- Diplomën nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP e cila mundë të shkarkohet nga uebfaqja e Kompanisë;
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

5. Afati i Konkursit:

Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data 11.09.2026 deri më 10.10.2026

Të interesuarit mund t'i dorëzojnë kërkesat (aplikacionet) e tyre me dokumentet tjera relevante në emailin: burimetnjerezore@pallatirinese.com

Formulari për kërkesë (aplikim) dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga ueb-faqja e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë në <http://www.pallatirinese.com/> ose mund të merren në zyrat e Ndërmarrjes.

6. Vërejtje:

Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurimit, do të refuzohen.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar
Agencija za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom
Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik Rishpallje

Datë 18.09.2026

Referenca: AAPSK – 010/2026

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:


N r	Përshkrimi	Sipërfaqja (m²)	Çmimi fillestar	Çmimi nga ofertuesi
1	Vilë model 'Zyre' P+0- Rishpallje	42.2 m²	4.700.00€	

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri me 23.09.2026 në ora 11:00 në Zonën Kadastrale, Çagllavicë,-në adresë: IT Group Shpk Maxhistrala Prishtinë- Ferizaj- KK Graçanicë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 23.09.2026, prej orës 10:00-11:00 në Zonën Kadastrale, Çagllavicë,-në adresë: IT Group Shpk Maxhistrala Prishtinë- Ferizaj- KK Graçanicë.

Pasuritë e sekuestruar ose të konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapsk.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/>.

Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 12:00.Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Na osnovu odredbi člana 21, tačke 21.4 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i na osnovu člana 17 Statuta, Upravni odbor N.P.L. PALLATI I RINISE AD, od 11.09.2026. godine, na osnovu Odluke Br. 1/2058 objavljuje ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje jedne (1) pozicije

1. Naziv radnog mesta: Generalni savetnik - Sekretar preduzeća

Lokacija: Priština.

Preduzeće: N.P.L. PALLATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini.

Odgovoran: Upravnom odboru.

Mandat: 3 godine

Koeficijent: 5.9

2. Generalni savetnik - Sekretar preduzeća ima sledeće dužnosti i odgovornosti: Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove iz člana 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) nisu, ili u bilo kom trenutku tokom trideset šest (36) meseci pre datuma podnošenja zahteva nisu bili, direktori Upravnog odbora relevantne kompanije i (iv) imaju neophodno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju; Svako lice koje želi da bude razmatrano za poziciju direktora mora takođe ispunjavati sledeće uslove stručne podobnosti:

- Posedovati univerzitetsku diplomu - Pravni fakultet (diplomirani pravnik ili master pravnih nauka);

- Posedovati najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti korporativnog upravljanja ili kompanijskog prava;

- Ispunjavati kvalifikacione uslove iz člana 17.1 i ispunjavati kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i izmene ZJP br. 04/L-111, član 13;

- Sposobnost za timski rad;
- Posedovati dobre komunikacijske veštine;
- Posedovati radnu etiku i integritet.
- Posedovati računarske veštine;
- Znanje engleskog jezika (poželjno);
- Dokazi o drugim znanjima i dostignućima biće uzeti u obzir i procenjeni u skladu sa relevantnošću za posao;
- Biti osoba sa visokim integritetom i ispunjavati sve uslove podobnosti utvrđene članom 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 i relevantnim izmenama, Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija br. 06/L-011, kao i drugim relevantnim pozitivnim normama.

3. Generalni savetnik - Sekretar kompanije ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Osigurati da se poštuju procedure Odbora, uključujući organizaciju sastanaka Odbora, odbora Odbora i akcionara, uključujući (u saradnji sa predsednikom) pripremu i distribuciju dnevnog reda;
- Voditi registar akcionara;
- Koordinirati sa Izvršnom komisijom pripremu materijala za sastanke Odbora direktora;
- Voditi zapisnike sa sastanaka Odbora direktora i Odbora za reviziju (osim ako njihovi predsednici ne zahtevaju drugačije) i evidentirati ih u zapisnicima;
- Distribuirati zapisnike direktorima i akcionarima;
- Obavljati zvaničnu registraciju promena koje zahteva zakon, evidentirajući ih u Kosovskom registru trgovačkih društava i trgovačkih imena;
- Prema uputstvima predsednika, odgovornosti Sekretara uključuju obezbeđivanje nesmetanog protoka informacija unutar Odbora i njegovih odbora i između Odbora i višeg menadžmenta Kompanije;
- Saveti i usluge Sekretara biće dostupni svim direktorima i biće odgovoran Odboru za obezbeđivanje usklađenosti sa procedurama Odbora;
- Prati pravne promene koje se odnose na Društvo tako što obaveštava Upravni odbor i rukovodstvo Društva o promenama i priprema neophodna uputstva za rukovodstvo Društva. Takođe se bavi i drugim pitanjima korporativnog upravljanja po potrebi.

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog fonda za penzijsku štednju, i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili u obavezi da plaćaju ovoj instituciji);
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa veb stranice Kompanije;
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak podnetih dokumenata.

5. Rok za konkurs:

Javni konkurs je otvoren u periodu od 30 (trideset) dana od 11.09.2026 do 10.10.2026.

Zainteresovana lica mogu podneti svoje prijave sa ostalom relevantnom dokumentacijom na imejl adresu: burimetnjerezore@pallatirinise.com

Obrazac za prijavu i izjava pod zakletvom mogu se preuzeti sa veb stranice N.P.L. PALLATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini na <http://www.pallatirinise.com/> ili se mogu dobiti u kancelarijama Kompanije.

6. Napomena:

Kandidati sa nepotpunom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van roka za konkurs biće odbijeni.

Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju navedene kriterijume i koji su uvršteni u uži izbor.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Halë Berisha shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme “Remzi Ademaj” Prizren, diplomën dhe dëftesën e provimit.

- Bosnalijek farmaceutska i Hemijaska Industrija dionicko Društvo Kosova Branch Dega në Kosovë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810122309.

- “Master Build SRL Dega në Kosovë” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811932583.

- Thot Ratkoceri shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “28 Nëntori” shkolla Teknike Prishtinë.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi “ Prizren.

- Trim Reznici shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hyni Zajmi” Gjakovë.

- Sebastian Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.

- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

